FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 186

Tiranë – E martë, 27 tetor 2015

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 108/2015 datë 15.10.2015	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10139, datë 15.5.2009, "Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë".....	12467
Ligj nr. 110/2015 datë 15.10.2015	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiardhe kontrollin".....	12468
Ligj nr.111/2015 datë 15.10.2015	Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar.....	12472
Ligj nr. 112/2015 datë 15.10.2015	Për inspektimin financiar publik.....	12475
Ligj nr. 113/2015 datë 15.10.2015	Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar.....	12481
Vendim i Kuvendit nr. 89/2015, datë 22.10.2015	Për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi për administrimin e bazave të të dhënave shtetërore tatimore.....	12486
Vendim i Kuvendit nr. 90/2015, datë 22.10.2015	Për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për verifikimin e ligjshmërisë së emërimeve në detyrë në administratën shtetërore, entet publike apo shoqëritë tregtare shtetërore, për periudhën 15 shtator 2013 – 30 shtator 2015.....	12487
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 866, datë 23.10.2015	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.638, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015 - 2016".....	12488

LIGJ
Nr. 108/2015

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10139, DATË 15.5.2009, "PËR PENSIONET SHTETËRORE SUPLEMENTARE TË PUNONJËSVE TË UNIVERSITETEVE, TË SHKOLLAVE TË LARTA, QENDRËS SË STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE, AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË GJITHA INSTITUCIONEVE TË TJERA KËRKIMORE PUBLIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË CILËT KANË TITUJ SHKENCORË"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.10139, datë 15.5.2009,"Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë", bëhen këto shtesa e ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2 bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në fund të shkronjës "a", të pikës 3, shtohet shprehja:

"si dhe personat me tituj shkencorë "Profesor", "Docent", "Bashkëpunëtor i vjetër shkencor", të cilët i kanë pasur këto tituj para vitit 1994 dhe i kanë përfituar pasi është fituar më parë grada shkencore "Kandidat i shkencave".

2. Në pikën 3, pas shkronjës "b" shtohet shkronja "c" me këtë përmbajtje:

"c) institucionet jopublike, ku punësimi i personave me tituj vlerësohet si periudhë e ushtrimit të titullit, për efekt të këtij ligji, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

3. Pika 4 ndryshohetsi më poshtë:

"4. "Pagë referuese" është paga bazë për titullin në institucionet publike, përjashtuar shtesat për funksion. Për efekt të përcaktimit të përfitimeve, paga referuese llogaritet si mesatare e pagave referuese, sipas viteve të ushtrimit të titullit.".

Neni 2

Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 4
Masa e kontributeve

Masa e kontributit suplementar që paguhet nga të punësuarit e përfshirë në këtë skemë suplementare është:

a) 5 për qind e pagës referuese të titullit për të punësuarit në sektorin publik;

b) 7 për qind e pagës referuese të titullit për të punësuarit në sektorin jopublik.

Neni 3

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 5
Pagesa e kontributeve

Pagesa e kontributeve suplementare bëhet në organet e tatim-taksave dhe ndjek të njëjtat procedura e afate, si për mbledhjen e kontributeve nga skema e sigurimit shoqëror të detyrueshëm.".

Neni 4

Neni 7 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 7
Masa e pensionit

1. Masa mujore e pensionit suplementar është 1,3 për qind e pagës referuese për çdo periudhë njëvjeçare të ushtrimit të titullit "Profesor" / "Drejtues kërkimesh" dhe 1,1 për qind e pagës referuese për çdo periudhë njëvjeçare të ushtrimit të titullit "Asistent profesor"/ "Mjeshtër kërkimesh".

Masa e pensionit suplementar për çdo periudhë njëvjeçare të ushtrimit të titullit "Docent" dhe të titullit "Bashkëpunëtor i vjetër shkencor" është 1,1 për qind e pagës referuese. Paga referuese përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Shuma mujore e pensionit suplementar, bashkë me përfitimet ngaligji nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nuk mund të jetë më e madhe se dyfishi i pensionit të pleqërisë, të

përfituar sipas ligjit nr.7703,datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

3. Masa mujore e pensionit suplementar nuk mund të jetë në asnjë rast më e vogël se 6 për qind e pagës referuese.

4. Masa mujore e pensionit suplementar fillestar për personat që nuk kanë kontribuar nuk mund të jetë më shumë se 50 për qind e pensionit të pleqërisë, të përfituar sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.".

Neni 5

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 8
Indeksimi

Pensionet shtetërore suplementare indeksohen. Koha dhe masa e indeksimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 6

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 10
E drejta për përfitim

1. E drejta për pension suplementar nuk parashkruhet.

2. Personit, që kërkon pensionin suplementar, brenda 1 viti nga data që i ka lindur e drejta, i jepet ky pension që nga ajo datë. Në raste të tjera, pensioni paguhet nga data e regjistrimit të kërkesës.

3. Përfitimet e njohura nga ky ligj, por të patërhequra, do të paguhen në çdo kohë, por jo më shumë se tre vjet.

4. Përfitimet e caktuara, por të paguara më pak, jepen në çdo kohë, por jo më shumë se për tre vjet.

5. E drejta e organit kompetent për të kërkuar shumat e marra tepër gjatë një viti ushtrohet jo më vonë se tre vjet nga data e marrjes së tyre, por jo më vonë se gjashtë muaj nga data e konstatimit dhe masa e ndalesës për çdo muaj është 20 përqind e kështit mujor të përfitimit.".

Neni 7

Pas nenit 10 shtohet neni 10/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 10/1
Të drejtat e fituara

Pensionet shtetërore suplementare me datë fillimi deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përfshi edhe këtë datë, caktohen sipas dispozitave ligjore që kanë qenë në fuqi deri në atë datë dhe nuk janë objekt ndryshimi apo rillogaritjeje, përveç indeksimit, sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 8

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 14
Përfitimi nga ligje të ndryshme

Pensioni suplementar, sipas këtij ligji, përfitohet edhe në rastet kur personi përfiton pension të posaçëm shtetëror, pension nga një skemë tjetër suplementare ose trajtim të veçantë, me kusht që periudhat e shërbimit të mos mbivendosen.".

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 15.10.2015

Shpallur me dekretin nr. 9284, datë 23.10.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ
Nr. 110/2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.10296, DATË 8.7.2010, "PËR MENAXHIMIN FINANCIAR DHE KONTROLLIN"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimine Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010,"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 3, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

"Ky ligj zbatohet në njësitë publike, ku përfshihen:".

Neni 2

Në nenin 4 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në fund të pikës 5 shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

"Njësia e qeverisjes qendrore përfshin organin qendror të njësisë dhe njësitë e varësisë, të kontrolluara prej saj.".

2. Në fund të pikës 6 shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

"Njësia e qeverisjes vendore përfshin organin qendror të njësisë dhe njësitë e varësisë, të kontrolluara prej saj.".

3. Në fund të pikës 7 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Njësia e fondeve speciale përfshin organin qendror të njësisë dhe njësitë e varësisë, të kontrolluara prej saj.".

4. Pika 8 ndryshohet si më poshtë:

"8.Të gjitha nivelet e njësisë publike ose njësi janë terma që u referohen njësive të përmendura në nenin 3, të këtij ligji, dhe nënkuptojnë organin qendror të njësisë publike dhe secilën njësi vartëse, të konsideruar më vete.".

5. Pas pikës 19 shtohet pika 19/1 me këtë përmbajtje:

"19/1. "Veprimtaritë kryesore" janë ato veprimtari që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë dhe përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve, projekteve më të rëndësishme të saj.".

6. Në fund të pikës 22shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Në kuptim të këtij ligji, titullar i njësisë publike,që drejtohet me organe vendimmarrëse kolegjiale, por që nuk organizohet si shoqëri tregtare, konsiderohet ky organ.".

7. Pas pikës 22 shtohet pika 22/1 me këtë përmbajtje:

"22/1. Titullar i njësisë në shoqëritë tregtare konsiderohet organi përgjegjës përpërcaktimin e politikave të shoqërisë, sipas ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.".

8. Pas pikës 23 shtohet pika 23/1 me këtë përmbajtje:

"23/1. Nëpunësautorizues i nivelittëdytë dhe/ose i niveleve të tjera janë nëpunës të administratës publike në secilën nga njësitë vartëse,me buxhet më vete të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, përgjegjës për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxhetit të tyre, që përgjigjet përpara nëpunësit autorizues.".

9. Në pikën 24, emërtimi "Nëpunës i nivelit të lartë menaxhues të njësisë" zëvendësohet me emërtimin "Nëpunës i nivelit menaxherial të njësisë".

Neni 3

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 5

Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, nëpërmjet të cilave burimet financiare janë planifikuar, drejtuar dhe kontrolluar për të mundësuar dhe influencuar ofrimin me efikasitet dhe efektshmëritë shërbimeve publike.Ky sistem vendoset, ruhet dhe përditësohet rregullisht nga titullari i njësisë publike dhe vihet në zbatim nga i gjithë personeli, me qëllim për të adresuar risqet e për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

a) veprimtarive efektive, të efektshme dhe me ekonomi;

b) pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;

c) informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;

ç) mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.".

Neni 4

Në nenin 6, pika 1, pas shkronjës "e" shtohet shkronja"ë" me këtë përmbajtje:

"ë) funksionet dhe detyrat e strukturës përgjegjëse për financat në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.".

Neni 5

Në nenin 8, pika 8, bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën“a”, fjalët “hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave” zëvendësohen me fjalët “miratimin e politikave dhe monitorimin e objektivave”.

2. Shkronja“d” ndryshohet si më poshtë:

“d) propozimin e një strukture të përshtatshme organizative dhe vendosjen e linjave të raportimit, që mundësojnë kryerjen efektive të përgjegjësive të tyre, përveç rasteve kur legjislacioni i posaçëm parashikon ndryshe;”.

Neni 6

Në nenin 9 bëhen shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Nëpunësi autorizues i njësisë publike, për efekt të menaxhimit financiar dhe kontrollit, cakton nëpunës autorizues të nivelit të dytë drejtuesit e programeve e nënprogrameve të çdo strukture dhe njësie të varësisë direkte, për të cilat identifikohet buxhet i veçantë. Në njësitë publike të përshkallëzuara me disa nivele njësish shpenzuese, nëpunësit autorizues caktohen nga organi epror direkt dhe emërtohen sipas nivelit të varësisë në nëpunës autorizues të nivelit të dytë, të tretë etë katërt.”.

2. Fillimi i fjalisë së parë, tëpikës3, ndryshohet si më poshtë:

“3. Nëpunësit autorizues tëtë gjitha niveleve të njësive të varësisë janë përgjegjës dhe raportojnë sipas shkallës hierarkike,”.

3. Shkronja “ç”, e pikës 4, shfuqizohet.

Neni 7

Neni 10 ndryshohetsi më poshtë:

“Neni 10

Përgjegjshmëria menaxheriale e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut

1. Koordinator i menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinator i riskut është nëpunësi autorizues i njësisë publike.

2. Në përmbushje të përgjegjësive të tij, nëpunësi autorizues mund t’i delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollin e koordinimin e riskut punonjësve, pjesë të strukturës së financës.

3. Përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.”.

Neni 8

Në nenin 12 bëhen ndryshimi dheshtesa e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Nëpunës zbatues i njësisë publike është drejtuesi i strukturës përgjegjëse për financat të njësisë publike, në varësi direkte nga nëpunësi autorizues i njësisë dhe që ka përfunduar studimet e ciklit të dytë në shkencat ekonomike ose zotëron diplomë universitare tëekuivalentuar me të, me përvojë pune jo më pak se pesë vjet në profesion. Nëpunësi zbatues emërohet në njësi, sipas kuadrit ligjor në fuqi, duke respektuar plotësimin e kërkesave të kësaj pike.”.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1. Në njësitë publike të ndërtuara me më shumë se dy nivele varësie, punonjësit e financës në strukturat përgjegjëse të financave, të vendosur në nivelet e poshtme të varësisë, konsiderohen punonjës të deleguar të nëpunësit zbatues të njësisënga varen. Punonjësit e financës, të vendosur në nivelet e poshtme të varësisë,duhet të kenë përfunduar të paktën studimet e ciklit të parë në shkencat ekonomikedhe raportojnë në mënyrë të dyfishtë te nëpunësi zbatues i njësisë nga varen dhe nëpunësi autorizues përkatës.”.

Neni 9

Në nenin 15, pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Delegimi i të drejtave dhe i detyrave nuk cenon të drejtat e menaxheritdhe nuk e shkarkon atë nga përgjegjësia administrative për realizimin e objektivave, kontrollin e risqeve përkatëse apo për përzgjedhjen e vartësit, tek i cili delegohen të drejtat dhe detyrat. Delegimi kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.”.

Neni 10

Në nenin 16, pika 2, fjalët “të detajuara për procedurat kryesore” zëvendësohen mefjalët “për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë”.

Neni 11

Në nenin 18bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1, fjalët "sipas pikave 1 dhe 2, të nenit 3," zëvendësohen me fjalët "sipas pikës 1, të nenit 3,".

2. Në pikën 2, fjalët "fundi i muajit prill," zëvendësohen me fjalët "fundi i muajit maj,".

3. Pika 3 riformulohet si më poshtë:

"3. Ministri i Financave u paraqet Këshillit të Ministrave dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit, brenda muajit qershor të çdo viti, raportin vjetor për cilësinë dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm financiar publik për vitin paraardhës, përfshirë edhe gjetjet e rëndësishme dhe rekomandimet për përmirësimin e sistemit.".

Neni 12

Në nenin 22, pika 3, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në fund të shkronjës"b", fjalët "sipas udhëzimit të Ministrit të Financave" shfuqizohen.

2. Në fund shkronjës "c" shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"apo të nëpunësve të deleguar prej tyre sipas shkallës së riskut të lidhur me të, të vlerësuar për çdo angazhim.".

Neni 13

Në nenin 25, pika 1ndryshohetsi më poshtë:

"1. Ministri i Financave, në përmbushjen e detyrave të tij, sipas nenit 3, të këtij ligji, mbështetet nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, si pjesë estrukturës përgjegjëse për harmonizimin e kontrollit të brendshëm financiar publik.Struktura përgjegjëse për harmonizimin e kontrollit të brendshëm financiar publik i raporton nëpunësit të parë autorizues dhe ministrit përgjegjës të financave.".

Neni 14

Në nenin 26 bëhen shtesa dhe ndryshimii mëposhtëm:

1. Pas shkronjës "d", të pikës 1, shtohet shkronja"dh" me këtë përmbajtje:

"dh) krijimin dhe përditësimin e regjistrit të nëpunësve autorizues dhe nëpunësve zbatues të njësive publike.".

2. Pika 4 shfuqizohet.

Neni 15

Neni 28 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 28

Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik

1. Në Ministrinë e Financave ngrihet Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, me detyrën e mbikëqyrjes së çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm, në sektorin publik.

2. Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik përbëhet nga Ministri i Financave, në cilësinë e kryetarit të këtij bordi, nëpunësi i parë autorizues, drejtuesi i strukturës përgjegjëse për kontrollin e brendshëm financiar publik, drejtuesi i strukturës përgjegjëse për buxhetin, drejtuesi i strukturës përgjegjëse për thesarin, tre anëtarë të emëruar nga Ministri i Financave, me përvojë në fushat e menaxhimit financiar dhe kontrollit, kontabilitetit dhe auditimit të brendshëm.".

3. Bordi shqyrton nevojën për miratimin e legjislacionit shtesë apo për përmirësimin e kuadrit rregullator të kontrollit të brendshëm financiar publik.

4. Bordi diskuton rreth raportit vjetor për kontrollin e brendshëm financiar publikpara se të miratohet nga Ministri i Financave.

5. Struktura përgjegjëse për harmonizimin e kontrollit të brendshëm financiar publik, në Ministrinë e Financave, siguron shërbimin e sekretariatit për veprimtarinë e bordit.

6. Mënyra e organizimit dhe funksionimit tëborditmiratohet me urdhër të Ministrit të Financave.

7. Masa e shpërblimit të anëtarëve të bordit dhe të sekretarit të bordit miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin eMinistrit të Financave.".

Neni 16

Kudo në përmbajtjen e këtij ligji bëhen këto ndryshime:

1. Emërtim i "Njësia Qendrore e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit" zëvendësohet me emërtimin "Struktura Përgjegjëse për Harmonizimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit".

2. Emërtimi "Njësi e sektorit publik" zëvendësohet me emërtimin "Njësi Publike".

Neni 17
Dispozita kalimtare

Kërkesat e pikave 1 dhe 3.1, të nenit 12, do të përmbushen brenda një periudhe kalimtare dyvjeçare, deri në implementimin e kërkesave ligjore për nëpunësin zbatues.

Neni 18

Ngarkohet Ministri i Financave që,brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 15.10.2015

Shpallur me dekretin nr. 9286, datë 23.10.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ
Nr. 111/2015

PËR SHËRBIMIN GJEOLOGJIK SHQIPTAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA Të PëRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të përcaktojë parimet e organizimit, drejtimit, bazat dhe detyrat e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.

Neni 2
Objekti

Ky ligj rregullon marrëdhëniet ndërmjet Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dhe sektorëve publik e privat, për nxitjen e shfrytëzimit të resurseve minerare në përfitim maksimal të publikut.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj me termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Ministria" është ministria përgjegjëse për veprimtarinë e shërbimit gjeologjik.
2. "Ministër" është ministri përgjegjës për shërbimin gjeologjik.
3. "Mineral" është çdo substancë në gjendje të ngurtë, të lëngët e të gaztë, që ndodhet në trajtë natyrore mbi ose nën tokë, në ose nën ujë, formuar prej proceseve gjeologjike.
4. "Mineral i dobishëm" është çdo substancë në gjendje të ngurtë, të lëngët e të gaztë, që ndodhet në trajtë natyrore mbi ose nën tokë, në ose nën ujë, formuar prej proceseve gjeologjike, që plotëson kushtet gjeologjike, minerare dhe teknologjike për përdorim në degë të ndryshme të ekonomisë.
5. "Ujëra nëntokësore" janë të gjitha ujërat e zonës së ngopjes, që formojnë shtresa, me dhe pa trysni.
6. "Basen ujor" ka kuptimin që jepet në ligjin "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore".
7. "Shkenca të tokës" janë disiplinat kryesore, si: gjeologjia, metalogjenia, gjeokimia, gjeofizika, hidrogjeologjia, gjeologjia inxhinierike, gjeomjedisi, mineralogjia, petrografia, petrologjia, paleontologjia, stratigrafia, topografia dhe pedologjia.
8. "Kërkim-zbulim" janë fazat metodike të kryerjes së vrojtimeve, studimeve, vlerësimeve, punimeve gjeologjike komplekse, me qëllim identifikimin e ekzistencës së mineraleve të dobishme.
9. "Vlerësim" është përcaktimi cilësor e sasior i mineralit, në përputhje me kërkesat teknikoekonomike të çdo stadi studimor.
10. "Agrogjeologji" është studimi kompleks i tokës për përdorimin efektiv dhe mbrojtjen e saj.
11. "Autoritet shkencor" është një person me gradë ose titull shkencor.

KREU II
OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË
SHËRBIMIT GJEOLOGJIK SHQIPTAR

Neni 4
Shërbimi Gjeologjik Shqiptar

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar është institucion këshillimor, teknik dhe shkencor i shtetit, person juridik publik, buxhetor, i cili kryen veprimtari në fushën e shkencave të tokës në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 5
Organizimi

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar organizohet si Drejtori e Përgjithshme, në varësi të ministrit dhe e ka selinë e tij në Tiranë.

Neni 6
Veprimtaria

Në veprimtarinë e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar përfshihen:

a) studimet gjeologjike sistematike bazë në tokë, në dete, në liqene dhe lumenj, në territorin e Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet harto-grafimeve komplekse të shkallëve të ndryshme për administrimin e territorit e të mineraleve;

b) studimet e thelluara shkencore për gjeologjinë dhe metalogjeninë;

c) studimet gjeofizike e gjeokimike të çdo shkalle;

ç) studime dhe promovime të perspektivës së mineraleve të dobishme;

d)studimet hidrogjeologjike të baseneve ujore, monitorimi i tyre dhe përcaktimi i masave për ruajtjen e rezervave ujore nëntokësore;

dh) studimet gjeologjike komplekse për mjedisin dhe monitorimin e tij, në funksion të planifikimit e të administrimit të territorit;

e)studime gjeologo-inxhinierike dhe rreziqet gjeologjike;

ë) studime agrogjeologjike dhe studime për erozionin;

f)studime, vlerësime dhe monitorime të gjeo-monumenteve;

g)kërkime dhe vlerësime të mineraleve metalore, hidrokarbureve, mineraleve industriale, burimeve ujore nëntokësore, ujërave të pijshme e industriale, ujërave minerale e termale;

gj) vlerësimi, mbikëqyrja dhe monitorimi i lejeve minerare të kërkim-zbulimit;

h) matjet topo-gjeodezike;

i) krijimi i bazës së të dhënave gjeologjike, bilanceve të rezervave të mineraleve të dobishme, rezervave të ujërave nëntokësore, rreziqeve gjeologjike dhe vënia në dispozicion e tyre organeve të pushtetit qendror e vendor, subjekteve të tjera të interesuara, përgatitja dhe publikimi i informacionit.

Neni 7
Marrja e të dhënave dhe informacioneve

1. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar ka të drejtë dhe detyrë të grumbullojë dhe të ruajë në Arkivin Qendror Teknik të Gjeologjisë të gjithë informacionin e dokumentacionin e përfituar deri tani dhe atë që do të përfitohet në të ardhmen në fushën e gjeologjisë bazë, të mineralogjisë, të gjeofizikës, gjeokimisë, stratigrafisë, hidro-gjeologjisë, gjeologjisë inxhinierike, topogjeodezisë, kampionaturën, provat e dublikatet e tyre, të sistemojë, të ruajë, të përpunojë e të informatizojë këto informacione dhe t'i përdorë sipas rregullave që përcaktohen në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

2. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore është e detyruar të dorëzojë në Arkivin Qendror Teknik të Gjeologjisë, për qëllime studimore, raportet e studimeve të çdo lejeje hidrokarbure kërkim-zbulimi.

3. Në Arkivin Qendror Teknik të Gjeologjisë arkivohet informacioni gjeologjik i çdo zotëruesi të lejes minerare e të lejeve të kërkim-zbulimit, duke respektuar kërkesat e ligjit minerar.

4. Pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar arkivohet edhe dokumentacioni gjeologjik krahinor i studimeve dhe lejeve, si dhe dokumentacioni faktik i punimeve gjeologjike, hidrogjeologjike, gjeologo-inxhinierike e inxhinierike të çdo natyre të gërmimit të tokës, të kryera nga subjekte private apo shtetërore në fazën e zbatimit të projektit dhe raportit përfundimtar.

Neni 8
Aksesi ndaj projekteve hidrogjeologjike

1. Personi, fizik ose juridik, privat ose shtetëror, që kryen shpime për ujërat nëntokësore, me thellësi mbi 15 m nga sipërfaqja e tokës, përpara se të paraqesë projektin hidrogjeologjik në këshillin e baseneve, është i detyruar të marrë miratimin për

projektin nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, që e shqyrton sipas akteve ligjore përkatëse.

2. Pas miratimit të lejes, një kopje e projektit dhe një kopje e relacionit për rezultatet e punimeve të kryera depozitohen në Arkivin Qendror Teknik të Gjeologjisë.

Neni 9
Kryerja e shërbimeve për të tretët

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar kryen shërbime me pagesë për të tretët, sipas parashikimeve të nenit 6 të këtij ligji. Për studime dhe projekte që kryhen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisëmerret miratimi i ministrit.

KREU III
ORGANIZIMI

Neni 10
Drejtimi

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe, në mungesë të tij, nga Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm.

Neni 11
Këshilli teknik

1. Brenda strukturës së Shërbimit Gjeologjik Shqiptar funksionon Këshilli Teknik Shkencor.

2. Këshilli Teknik Shkencor bën diskutimin dhe miratimin e programeve të zhvillimit, projekteve dhe raporteve studimore të ndryshme.

3. Përbërja e Këshillit Teknik Shkencor dhe rregullorja e funksionimit të tij miratohen nga ministri, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm.

Neni 12
Marrëdhëniet e punës

1. Marrëdhëniet e punës së Drejtorit të Përgjithshëm dhe nëpunësve të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar rregullohen në bazë të legjislacionit për nëpunësin civil.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar duhet të jetë person me autoritet shkencor dhe me përvojë pune në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar ose struktura të tjera të këtij lloji.

Neni 13
Kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm

Drejtori i Përgjithshëm ka këto kompetenca:

a) drejton dhe menaxhon veprimtarinë e institucionit;

b) përfaqëson Shërbimin Gjeologjik Shqiptar në marrëdhëniet me të tretët;

c) administron buxhetin e miratuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe përgatit projektbuxhetin për vitin e ardhshëm;

ç) nxjerr urdhra dhe udhëzime për veprimtarinë e strukturave të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar;

d) i propozon për miratim ministrit rregulloret dhe aktet në zbatim të këtij ligji.

Neni 14
Funksionimi i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar funksionon me një rregullore të veçantë, e cila miratohet nga ministri.

KREU IV
MëNYRA DHE BURIMET E FINANCIMIT

Neni 15
Financimi

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar financohet nga Buxheti vjetor i Shtetit dhe nga të ardhurat e shërbimeve me të tretët.

Neni 16
Tarifat e shërbimeve

1. Tarifat e shërbimit me pagesë për të tretët, që kryhen nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, miratohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe ministrit.

2. Të ardhurat e krijuara nga shërbimet me të tretët përdoren nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 17
Pjesëmarrja në projekte

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar paraqet dhe merr miratim nga ministri për pjesëmarrjen në projektet dypalëshe ose shumëpalëshe, brenda dhe jashtë shtetit.

Neni 18
Aktet nënligjore

Ngarkohet ministri që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore, sipas neneve 11, 14 dhe 16 të këtij ligji.

Neni 19
Shfuqizime

Ligji nr.8366, datë 2.7.1998, "Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar", të ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 20
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 15.10.2015

Shpallur me dekretin nr. 9287, datë 23.10.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ
Nr. 112/2015

PËRINSPEKTIMIN FINANCIAR PUBLIK

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton qëllimin, parimet dhe rregullat e përgjithshme të inspektimit financiar publik, si dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave të përfshira në proces.

Neni 2
Misioni

Misioni i inspektimit financiar publik është garantimi i zbatimit të ligjshmërisë në përdorimin e fondeve publike dhe dhënia e ndihmës në përmirësimin e menaxhimit financiar publik.

Neni 3
Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka si qëllim mbrojtjen e interesave financiarë të njësive publike, kundrejt keqmenaxhimit të rëndë financiar, mashtrimit, vjedhjes, shkatërrimit të pronës, shpërdorimit të detyrës apo korrupsionit.

Neni 4
Fusha e zbatimit të ligjit

Subjekt i inspektimeve financiare publike janë:

a) njësitë e qeverisjes së përgjithshme;

b) shoqëritë shtetërore, organizatat jofitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta që zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme, ose në të cilën një njësi e qeverisjes së përgjithshme zotëron apo kontrollon një pjesë të aksioneve, e cila i jep të drejtën e kontrollit;

c) çdo person fizik apo juridik, vetëm për fondet që përfiton nga Buxheti i Shtetit, Bashkimi Europian apo fondet në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare, ku përfitues është shteti shqiptar.

Neni 5
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "AFCOS" është "Shërbimi i koordinimit të antimashtrimit", i caktuar në Shqipëri për të lehtësuarbashkëpunimin meorganetpërkatëse të Bashkimit Europian.

2. "Dëm pasuror", kuptimi i këtij termi është i njëjtë me atë të parashikuar në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.

3. "Fonde publike" janë të gjitha fondet, përfshirë fondet e Bashkimit Europian dhe të donatorëve të tjerë, të cilat mblidhen, arkëtohen, mbahen, shpërndahen dhe shpenzohen nga njësitë publike dhe që përbëhen nga të ardhurat, shpenzimet, kreditë dhe grantet për njësitë publike.

4. "Garanci financiare" është shuma e ngurtësuar në zbatim të një marrëveshjeje, të nënshkruar nga njësia e qeverisjes së përgjithshme, për të siguruar përmbushjen e një kontrate ose veprime të tjera, të ndërmarra nga një palë e tretë.

5. "Inspektor financiar publik" është personi i ngarkuar për kryerjen e inspektimit financiar publik.

6. "Keqmenaxhim i rëndë financiar" është veprimi ose mosveprimi i një titullari apo nëpunësi të një njësie publike, që mund të rezultojë ose ka rezultuar me paaftësi paguese financiare të njësisë ose me humbje të rëndësishme, përtej humbjeve/parashikimeve në buxhetin e miratuar.

7. "Marrëveshje ndërkombëtare" janë marrëveshjet ku përfitues është shteti shqiptar, kuptimi i të cilave jepet në ligjin "Për lidhjen e traktateve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare".

8."Mashtrim", "Vjedhje", "Shkatërrim i pronës", "Shpërdorim i detyrës", "Korrupsion" kanë kuptim të njëjtë me atë të parashikuar në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë.

9."Njësi të qeverisjes së përgjithshme" ka të njëjtin kuptim me përcaktimin në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor.

10. "OLAF" është Zyra Europiane Kundër Mashtrimit.

11. "Organizata jofitimprurëse" ka kuptimin sipas përkufizimit të dhënë në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin "Për organizatat jofitimprurëse".

12. "Parregullsi" është moszbatimi ose zbatimi i gabuar i ligjeve apo akteve të tjera nënligjore, që e ka origjinën te veprimet a mosveprimet e përdoruesit të fondeve publike, të cilat kanë ose mund të kenë pasoja të dëmshme për menaxhimin e fondeve publike, pavarësisht nëse ajo prek të ardhurat/të hyrat, shpenzimet/të dalat, fondet e kthyera mbrapsht, aktivin apo detyrimet financiare.

13. "Shoqëri shtetërore" ka kuptim të njëjtë me atë të parashikuar në ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 6
Parimet e inspektimit financiar publik

Inspektimi financiar publik realizohet sipas parimeve të përgjithshme të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

Neni 7
Veprimtaria e inspektimit financiar publik

1. Inspektimi financiar publik është veprimtari që kryhet pas faktit, për rregullshmërinë e transaksioneve dhe veprimtarive të tjera të menaxhimit financiar, të kryera nën përgjegjësinë e njësive publike dhe individëve, në mënyrë që:

a) të përcaktojë shkeljet e akteve normative, si dhe të provojë dyshimet për mashtrimet e kryera;

b) të zbulojë parregullsitë dhe dëmet e shkaktuara në pronën e njësive publike;

c) të identifikojë individët përgjegjës për shkeljet e kryera dhe të kërkojë marrjen e masave zhdëmtuese, administrative apo disiplinore, sipas shkallës apo llojit të përgjegjësisë.

2. Kjo veprimtari kryhet nga punonjësit e njësisë përgjegjëse për inspektimin financiar publik në Ministrinë e Financave. Në rastet e mungesës së burimeve njerëzore, si dhe mbulimit të fushave specifike të inspektimit financiar publik, angazhohen punonjës të administratës publike ose ekspertë të jashtëm. Procedurat e përzgjedhjes dhe të shpërblimit të ekspertëve të jashtëm, punonjës të administratës publike apo jashtë saj, të cilët do të angazhohen në kryerjen e inspektimit financiar publik, rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, të propozuar nga Ministri i Financave.

Neni 8
Baza për fillimin e inspektimit financiar publik

1. Inspektimi financiar publik nis vetëm mbi bazën e kërkesës, informacionit apo ankesës.

2. Burimet e kërkesës, informacionit apo ankesës janë:

a) kërkesa nga Presidenti i Republikës;

b) kërkesa nga Kryeministri;

c) kërkesa nga Ministri i Financave;

ç) kërkesa nga Kontrolli i Lartë i Shtetit;

d) kërkesa nga Prokurori i Përgjithshëm;

dh) kërkesa nga titullarët dhe nëpunësit autorizues të njësive publike;

e) kërkesa nga OLAF-i;

ë) informacione për parregullsi nga auditimi i brendshëm;

f) informacione të menaxhimit financiar dhe kontrollit;

g) ankesa nga punonjës në sektorin publik apo privat;

gj) ankesa nga çdo person fizik/juridik;

h) informacione apo ankesa nga persona anonimë, kur në to ekzistojnë elemente të keqmenaxhimit të rëndë financiar, mashtrimit, vjedhjes, shkatërrimit të pronës, shpërdorimit të detyrës apo korrupsionit.

KREU II
AUTORITETET VENDIMMARRËSE TË INSPEKTIMIT FINANCIAR PUBLIK

Neni 9
Detyrimet e Ministrit të Financave

1. Ministri i Financave është përgjegjës për rregullimin e funksionimit të centralizuar të inspektimit financiar publik.

2. Ministri i Financave nxjerr urdhra, udhëzime dhe miraton metodologji për:

a) kriteret për fillimin e inspektimit financiar publik, duke përfshirë dhe rëndësinë e shkeljes;

b) rregullat dhe procedurat e kryerjes së inspektimit financiar publik;

c) kodin e etikës për inspektorët financiarë publikë.

3. Ministri i Financave, bazuar në raportin përfundimtar të inspektimit, në vlerësimin e drejtuesit të njësisë përgjegjëse të inspektimit financiar publik, si dhe në miratimin e nëpunësit të parë autorizues, urdhëron marrjen e masave rregulluese, zhdëmtuese, administrative apo disiplinore.

4. Ministri i Financave caktonorganetqë formojnë rrjetin e raportimit të shërbimit AFCOS, ku bëjnë pjesë të gjitha autoritetet kombëtare, të përfshira në parandalimin, raportimin dhe eliminimin e parregullsive që lidhen me mbrojtjen e interesave financiare të Bashkimit Europian, me të cilat lidh marrëveshje bashkëpunimi.

5. Ministri i Financave, me propozim të nëpunësit të parë autorizues, heq nga lista e inspektorëve financiarë publikë punonjësit e administratës publike dhe ekspertët e jashtëm, në rast të shkeljeve në përmbushjen e detyrave gjatë kryerjes së veprimtarisë së inspektimit financiar publik.

Neni 10
Të drejtat e Ministrit të Financave

1. Bazuar në raportin e inspektimit financiar publik, në vlerësimin e drejtuesit të njësisë përgjegjëse të inspektimit financiar publik, si dhe në miratimin e nëpunësit të parë autorizues, Ministri i Financave ka të drejtë:

a) t'i propozojë titullarit të njësisë të ndërmarrë masat e duhura, me qëllim përfundimin e parregullsive ose/dhe shmangien e pasojave negative të këtyre veprimtarive;

b) t'i propozojë autoritetit përgjegjës, të ndërmarrë veprime të mëtejshme, të nevojshme, kur individi përgjegjës është një ministër ose titullar i njësisë së qeverisjes së përgjithshme;

c) t'u kërkojë autoriteteve përgjegjëse ndalimin e veprimtarive që çojnë në parregullsi ose që u shkaktojnë dëme njësive dhe individëve, subjekte të inspektimit;

ç) t'u kërkojë autoriteteve përgjegjëse ose titullarëve të njësive dhe individëve shfuqizimin / revokimin e akteve administrative, të lëshuara në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi;

d) t'u kërkojë autoriteteve përgjegjëse marrjen e masave për zhdëmtim dëmi ose masave administrative apo disiplinore, sipas procedurave përkatëse.

2. Në rastet e moszbatimit të shkronjave "c", "ç" dhe "d", të pikës 1, të këtij neni, Ministri i Financave, me propozim të nëpunësit të parë autorizues, mund të urdhërojë:

a) bllokimin e përdorimit të fondeve buxhetore, të përcaktuara nëligjin vjetor të Buxhetit të Shtetit për vitin përkatës, në nivel programi, zëri apo projekti, deri në raportimin për zbatimin e masave të marra, sipas pikës 1 të këtij neni;

b) bllokimin e llogarive bankare të njësive publike, lidhur me fondet ku janë zbuluar parregullsi, deri në eliminimin e parregullsive.

Neni 11
Funksionet e nëpunësit të parë autorizues

1. Nëpunësi i parë autorizues është autoriteti përgjegjës për fillimin e inspektimit financiar publik. Vendimi i nëpunësit të parë autorizues merret bazuar në mendimin e njësisë përgjegjëse të inspektimit financiar publik.

2. Nëpunësi i parë autorizues, në rastet e ankesave, para se të marrë vendim për nisjen e inspektimit financiar publik, kur është e mundur, kërkon kryerjen e një inspektimi paraprak nga titullari i njësisë respektive apo njësisë publike që mbulon fushën specifike që lidhet me ankesën.

3. Nëpunësi i parë autorizues i dërgon subjektit të inspektuar urdhrin e Ministrit të Financave për përfundimin e inspektimit financiar publik, së bashku me raportin përfundimtar të inspek-timit. Një kopje e raportit të inspektimit i dërgohet edhe Kontrollit të Lartë të Shtetit.

4. Për fondet e Bashkimit Europian, funksionet e nëpunësit të parë autorizues për inspektimin

financiar publik i kryen Zyrtari Kombëtar Autorizues (NAO/ZKA).

KREU III
NJËSIA PËRGJEGJËSE PËR INSPEKTIMIN FINANCIAR PUBLIK

Neni 12
Struktura e njësisë përgjegjëse për inspektimin financiar publik

1. Njësia përgjegjëse për inspektimin financiar publik është pjesë e strukturës së Ministrisë së Financave.

2. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të njësisë përgjegjëse për inspektimin financiar publik, rregullohen nga legjislacioni në fuqi për nëpunësin civil.

3. Punonjësi i njësisë përgjegjëse për inspektimin financiar publik, në pozicionin e drejtuesit të njësisë, duhet të ketë diplomë universitare "Master i shkencave" ose ekuivalente me të, në shkencat ekonomike ose juridike, si dhe së paku 10 vjet përvojë profesionale në njësitë publike.

4. Punonjësi i njësisë përgjegjëse për inspektimin financiar publik, në pozicionin e inspektorit të kësaj njësie, duhet të ketë diplomë universitare "Master i shkencave" ose ekuivalente me të, si dhe të paktën 5 vjet përvojë profesionale në njësitë publike.

Neni 13
Funksionet e njësisë përgjegjëse për inspektimin financiar publik

Njësiapërgjegjëse për inspektimin financiar publik përmbush këto funksione:

1. Shqyrton kërkesat, informacionet apo ankesat dhe jep mendim te nëpunësi i parë autorizues për fillimin ose jo të inspektimit financiar publik apo të inspektimit paraprak.

2. Kryen inspektime financiare publike, sipas rregullave të miratuara nga ministri i Financave, si edhe është përgjegjëse për cilësinë e tyre.

3. Propozon te nëpunësi i parë autorizues dhe te Ministri i Financave masat që duhet të ndërmerren në përfundim të inspektimit financiar publik.

4. Monitoron zbatimin e masave të kërkuara nga Ministri i Financave në përfundim të inspektimit financiar publik, si dhe informon nëpunësin e parë autorizues për zbatueshmërinë e tyre.

5. Propozon për miratim urdhra, udhëzime dhe metodologji, sipas dispozitave të këtij ligji.

6. Kryen rolin e AFCOS-it dhe shërben si pikë kontakti e OLAF-it.

7. Paraqet te nëpunësi i parë autorizues dhe te Ministri i Financave raportin vjetor të veprimtarisë, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.

8. Kërkon dhe shkëmben informacion me njësi të tjera publike, në fushën e veprimtarisë së inspektimit financiar publik.

Neni 14
Funksionet e AFCOS-it

1. AFCOS-i koordinon, brenda vendit, të gjithadetyrimet ligjore, administrative, operative dhe aktivitetet që lidhen me mbrojtjen e interesave financiarë të BE-së.

2. Të drejtat e AFCOS-it janë:

a) t'i kërkojë autoritetit administrativ kombëtar përkatës ose autoritetit ligjor përkatës të analizojë informacionin, me qëllim fillimin e hetimeve;

b) t'i kërkojë autoritetit të sipërpërmendur të fillojë hetimin administrativ, nëse është e nevojshme;

c) të kërkojë të jetë i informuar për rezultatet e hetimit;

ç) të sigurojë shkëmbimin efektiv të informacionit me OLAF-in.

3. Në ushtrimin e veprimtarisë së tij, AFCOS-i ka për detyrë:

a) të jetë përgjegjës për pranimin e kontrolleve në vend dhe identifikimin konkret të autoriteteve administrative ose ligjore që mund t'i ofrojnë OLAF-it ndihmën e nevojshme;

b) të vendosë OLAF-in në kontakt me autoritetet kombëtare, në mënyrë që të sigurojnë bashkëpunimin operacional për rastet e hetimit;

c) të parashikojë mundësinë e krijimit të ekipeve të përbashkëta hetimore administrative apo inspektuese midis OLAF-it dhe autoriteteve kombëtare;

ç) të organizojë takime periodike me autoritetet kombëtare administrative dhe ligjore, në mënyrë që të informohet vazhdimisht për zhvillimin e hetimeve dhe të ndërhyjë në rast vonesash ose në rastin e mbështetjes së dobët nga ana e autoriteteve;

d) të sigurojë shkëmbimin efektiv të informacionit me OLAF-in.

Neni 15
Detyrimi për të dhënë informacion

Njësia përgjegjësepër inspektimin financiar publik jep informacion për inspektimet financiare publike të kryera, kur informacioni kërkohet nga autoritetet publike, të cilëve u jepet e drejta me ligj.

Neni 16
Të drejtat e inspektorëve financiarë publikë

Për zbatimin e detyrave të tyre, inspektorët financiarë publikë kanë këto të drejta:

a) hyrje të pakufizuar në mjediset e njësisë që është subjekt i inspektimit;

b) qasje të pakufizuar lidhur me inspektimin ndaj gjithë informacionit, sistemit të kontabilitetit, dokumentacionit elektronik dhe atë të klasifikuar, sipas nivelit të tyre të aksesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

c) kërkim të dokumenteve origjinale, të kopjeve zyrtare të dokumenteve, të informacionit dhe të referencave, të deklarimeve për të gjitha llogaritë bankare, si në vend dhe jashtë tij, si dhe të çdo dokumenti tjetër që ka lidhje me objektin e inspektimit financiar, në afate të përcaktuara;

ç) ushtrim të kontrolleve dhe të kërkimit të kopjeve zyrtare të dokumenteve, të informacionit dhe të referencave personave juridikë e fizikë, jashtë subjektit të inspektimit financiar, vetëm në lidhje me objektin e inspektimit financiar publik;

d) parandalim të hyrjes së individëve përgjegjës te kasafortat, magazinat dhe artikuj të tjerë, subjekte të inspektimit, duke i vulosur në praninë e një zyrtari nga njësia subjekt i inspektimit.

Neni 17
Detyrimet e inspektorëve financiarë publikë

1. Për ushtrimin e detyrave të tyre, inspektorët financiarë publikë janë të detyruar:

a) të identifikohen me një dokument identifikimi zyrtar dhe me vendimin e caktimit për kryerjen e detyrës së inspektimit financiar publik;

b) të raportojnë objektivisht dhe në mënyrë të saktë rezultatet e veprimtarisë së inspektimit të kryer, parregullsitë, shkeljet dhe dëmet e konstatuara, shkaqet e ndodhjes së tyre, në bazë të fakteve dhe të rrethanave të kontrolluara zyrtarisht nga ata;

c) të ruajnë sekretin për çdo fakt ose rrethanë të siguruar gjatë procesit të zbatimit të detyrave të tyre, me përjashtim të rasteve të lejuara me ligj;

ç) të kërkojnë ndërprerjen e çdo veprimi që gjykojnë se çon në kryerjen e një parregullsie;

d) të njohin dhe të zbatojnë kodin e etikës për inspektorët financiarë publikë.

2. Inspektorët financiarë publikë mund të pezullohen nga misioni i inspektimit, me propozim të drejtuesit të njësisë përgjegjëse për inspektimin financiar publik dhe me miratim të nëpunësit të parë autorizues, para përfundimit të misionit në këto raste:

a) kur vërtetohet ekzistenca e kushteve të konfliktit të interesit;

b) për shkelje gjatë kryerjes së inspektimit ose paaftësi në përmbushjen e inspektimit financiar publik.

Neni 18
Konflikti i interesit për inspektorët financiarë publikë

Konflikti i interesit për inspektorët financiarë publikë përfshin rastet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi që rregullon konfliktin e interesit, si dhe rastet kur:

a) në tre vitet e fundit të kenë punuar për njësinë ose për individin subjekt të inspektimit;

b) në tre vitet e fundit të kenë qenë pjesëmarrës në autoritetet menaxhuese ose mbikëqyrëse të njësive dhe/ose individëve subjekt inspektimi;

c) bashkëshorti/bashkëshortja apo bashkëjetuesi ose të afërmit deri në shkallë të dytë të kenë qenë të punësuar në tre vitet e fundit si autoritete menaxhuese ose mbikëqyrëse në njësitë subjekt inspektimi.

Neni 19
Të drejtat e subjekteve të inspektuara

1. Subjektet e inspektimit kanë të drejtë:

a) të kërkojnë të njihen me vendimin për fillimin e inspektimit financiar publik;

b) të kërkojnë identifikimin e inspektorëve financiarë publikë;

c) të jenë të pranishëm dhe të ndjekin, vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit të tyre, të gjitha veprimet e inspektimit;

ç) të kërkojnë dhe të marrin informacion nga inspektori për procedurën e inspektimit dhe për çdo veprim apo vendim të ndërmarrë gjatë saj;

d) të paraqesin, me shkrim apo me gojë, mendimet, shpjegimet për faktet, rrethanat apo

edhe për çështjet ligjore që kanë të bëjnë me inspektimin;

dh) të kërkojnë të njihen dhe t'u njoftohet procesverbali dhe aktkonstatimi i inspektimit;

e) të paraqesin kontestimet e tyre për vlerësimin e provave të administruara, për rezultatet e inspektimit dhe për vendimin që synohet të merret në përfundim të inspektimit.

2. Kur pjesëmarrja, gjatë kryerjes së inspektimit, sipas shkronjës "c", të pikës 1, të këtij neni, pengon kryerjen e veprimeve të inspektimit, inspektori mund të vendosë përjashtimin nga pjesëmarrja. Vendimi pasqyrohet në procesverbal dhe nuk mund të ankimohet veçmas.

Neni 20
Detyrimet e subjekteve të inspektuara

1. Çdo subjekt inspektimi është i detyruar:

a) të bashkëpunojë dhe të mos pengojë inspektorët financiarë publikë në procesin e ekzekutimit të detyrave të tyre;

b) t'u ofrojë inspektorëve financiarë publikë të drejtën e përdorimit të pakufizuar të mjediseve ku do të punojnë dhe të të gjithë dokumentacionit që lidhet me objektin e inspektimit;

c) të dorëzojë, brenda afateve të përcaktuara prej inspektorëve financiarë publikë, dokumentet, kopjet zyrtare të dokumenteve, informacionin dhe deklaratat për çdo llogari bankare dhe shpjegime të shkruara, si dhe raportet;

ç) të dorëzojë, brenda afateve të përcaktuara prej inspektorëve financiarë publikë, të dhëna të sakta, deklarimet dhe kopjet zyrtare të dokumenteve që kanë lidhje me objektin e inspektimit;

d) të zbatojë masat e kërkuara nga Ministri i Financave, sipas shkronjave "c", "ç" e "d", të pikës 1, të nenit 10, të këtij ligji, dhe, brenda një periudhe prej dy muajsh pas njoftimit të marrë, të informojë me shkrim nëpunësin e parë autorizues për masat e marra.

2. Çdo person fizik apo juridik subjekt inspektimi, sipas pikës 1, të këtij neni, nuk ka të drejtë të refuzojë dhënien e informacionit, duke iu referuar inspektimeve të mëparshme, kontrolleve nga njësitë e tjera ose sekretit bankar, si dhe informacionit të klasifikuar sekret shtetëror ose sekret profesional, për fushën objekt inspektimi dhe vetëm për personin e tij.

Neni 21
Përmbushja e inspektimit financiar publik

1. Inspektimi financiar publik kryhet në bazë të akteve nënligjore të miratuara nga Ministri i Financave, sipas pikës 2, të nenit 9, të këtij ligji.

2. Rregullat dhe procedurat për kryerjen e inspektimit financiar publik miratohen nga Ministri i Financave. Ato përmbajnë të gjitha proceset që kryhen gjatë një shërbimi inspektimi, pas marrjes së vendimit për fillimin e tij, deri në zbatimin e masave të kërkuara nga Ministri i Financave, sipas pikës 1, të nenit 10, të këtij ligji.

Neni 22
Informimi i autoriteteve

1. Informacioni për rezultatet e inspektimit financiar, të kryer në njësitë e qeverisjes qendrore dhe njësitë shpenzuese të fondeve publike, duhet t'i dorëzohet një njësie të një niveli më të lartë, kur përmban parregullsi.

2. Në rastin e inspektimit financiar të organeve të njësive të qeverisjes vendore dhe të njësive të tyre shpenzuese të fondeve publike, informacioni duhet t'i dërgohet, gjithashtu, këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, kur vërehen parregullsi.

3. Informacioni për rezultatet e inspektimit financiar, sipas shkronjës "b", të nenit 4, të këtij ligji, kur vërehen parregullsi, duhet t'i dërgohet autoritetit më të lartë që ushtron të drejtën e pronës shtetërore ose vendore te kapitali i njësisë ose individit që inspektohet.

KREU IV
SHKELJET DHE ANKIMET

Neni 23
Përgjegjësia për shkaktimin e dëmit

1. Për çdo dëm shkaktuar njësive publike dhe individëve, të vërejtur gjatë inspektimit financiar publik, duhet të mbahet përgjegjësi, sipas dispozitave të Kodit Civil.

2. Kur dëmi është shkaktuar nga shumë persona së bashku, këta përgjigjen solidarisht për dëmin, në bazë të dispozitave të Kodit Civil.

3. Çdo person që ka urdhëruar ose kryer pagesa në kundërshtim me ligjet në fuqi apo që ka marrë përsipër angazhime jashtë fondeve të parashikuara në buxhet është përgjegjës për shlyerjen e detyrimit.

Neni 24
Shkeljet penale

Kur të dhënat tregojnë dyshime të arsyeshme për ekzistencën e një vepre penale, nëpunësi i parë autorizues informon Ministrin e Financave dhe bën kallëzim me shkrim në prokurori.

Neni 25
Masat disiplinore

Kur inspektori financiar publik, punonjës i administratës publike, kryen shkelje gjatë përmbushjes së inspektimit, me kërkesë të drejtuesit të inspektimit financiar publik, nëpunësi i parë autorizues i kërkon autoritetit përgjegjës ku është i punësuar punonjësi fillimin e ecurisë disiplinore.

Neni 26
Ankimi në rrugë gjyqësore

Kundër masave të kërkuara nga Ministri i Financave, sipas pikave 1 dhe 2, të nenit 10, të këtij ligji, mund të bëhet ankim në gjykatën administrative kompetente, brenda 45 ditëve nga data e marrjes dijeni.

KREU V
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 27
Periudha kalimtare për zbatimin e ligjit

1. Ngarkohet Ministri i Financave që, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikave 2 dhe 4, të nenit 9, të tij.

2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 2, të nenit 7, të tij.

Neni 28
Shfuqizimet

1. Ligji nr.10294, datë 1.7.2010, "Për inspektimin financiar publik", si dhe çdo akt tjetër ligjor që bie në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohet.

2. Aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të ligjit nr.10294, datë 1.7.2010, "Për inspektimin financiar publik", mbeten në fuqi deri në miratimin e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, për aq sa nuk bien ndesh me parashikimet e këtij ligji.

Neni 29
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 15.10.2015

Shpallur me dekretin nr. 9288, datë 23.10.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ
Nr. 113/2015

PËR URDHRIN PROFESIONAL TË MJEKUT VETERINAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Urdhrit Profesional të Mjekut Veterinar, vendosjen e standardeve për ushtrimin e profesionit të mjekut veterinar, si dhe marrëdhëniet juridike të personave që e ushtrojnë këtë profesion.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për:
1. Mjekët veterinarë.
2. Farmacistët veterinarë.
3. Teknikët veterinarë.
4. Teknikët e ndërzimit.

KREU II
FUNKSIONIMI I URDHRIT
PROFESIONAL TË MJEKUT VETERINAR

Neni 3
Misioni

Misioni i urdhrit është ruajtja e standardeve të larta në formimin, sjelljen profesionale dhe ushtrimin e profesionit të mjekut veterinar, duke garantuar mbrojtjen e shëndetit e mirëqenies së kafshëve dhe mbrojtjen e shëndetit publik.

Neni 4
Kompetencat e urdhrit

Urdhri ushtron këto kompetenca:

a) jep, pezullon ose heq të drejtën për ushtrimin e profesionit për mjekët e farmacistët veterinarë, si dhe për teknikët veterinarë e teknikët e ndërzimit, në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe të statutit të Urdhrit;

b) mban dhe administron regjistrin e anëtarësisë për mjekun dhe farmacistin veterinar, si dhe regjistrin e veçantë të teknikëve veterinarë dhe teknikëve të ndërzimit;

c) vepron në mënyrë që të promovojë besimin e publikut ndaj këtij profesioni;

ç) kryen mbikëqyrje profesionale të aktiviteteve veterinare, sipas përcaktimeve të statutit të Urdhrit dhe rregulloreve të miratuara nga Këshilli Kombëtar;

d) mbikëqyr zbatimin e detyrave profesionale, në përputhje me kërkesat e shkencave veterinare dhe të legjislacionit veterinar;

dh) bashkëpunon me institucionet arsimore e shkencore për hartimin dhe planifikimin e programeve të formimit shkencor, të specializimit pasuniversitar dhe të kurseve të kualifikimit të vazhdueshëm të mjekut veterinar;

e) planifikon, monitoron dhe organizon trajnime profesionale për kandidatët për mjekë veterinarë dhe testime të aftësisë profesionale për këta kandidatë, në përputhje me ligjin nr. 10 171, datë 22.10.2009, "Për profesionet e rregulluara", të ndryshuar;

ë) përcakton të gjitha procedurat që lidhen me regjistrimin në Urdhër;

f) përgatit dhe nxjerr publikime, broshura, formularë dhe dokumente të tjera të ngjashme;

g) paraqet te ministri përgjegjës për veterinarinë propozime ligjore e nënligjore, lidhur me aktivitete të tjera në fushën e veterinarisë;

gj) përgatit programe trajnimi në fushën e veterinarisë, këshillon dhe merr pjesë në programe trajnimi, sipas përcaktimit të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi;

h) mbikëqyr zbatimin e kushteve të vendosura nga Kodi i Etikës Profesionale të Mjekut Veterinar;

i) përgatit dhe paraqet te ministri përgjegjës për veterinarinë, brenda 31 marsit të çdo viti pasardhës, një raport vjetor mbi ushtrimin e aktivitetit të tij, në përputhje me këtë ligj.

Neni 5
Kriteret për ushtrimin e profesionit të mjekut veterinar

1. Për të fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit çdo kandidat duhet të plotësojë këto kritere:

a) të jetë diplomuar në mjekësi veterinare, me një titull apo kualifikim zyrtar, të njësuar me diplomën apo kualifikimin zyrtar, në fushën përkatëse, në Shqipëri;

b) të kalojë provimin shtetëror, sipas përcaktimeve të ligjit për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë;

c) të jetë shtetas shqiptar ose shtetas i huaj, i cili ka të drejtë ligjore, sipas legjislacionit në fuqi, për të punuar në Shqipëri;

ç) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, në momentin e kërkesës për anëtarësim;

d) të njohë dhe të zotohet me shkrim se do të zbatojë kërkesat e legjislacionit në fuqi për shërbimin veterinar, statutin e Urdhrit dhe Kodin e Etikës së Mjekut Veterinar;

2. Mjeku dhe farmacisti veterinar për të fituar të drejtën për ushtrimin e profesionit, duhet të jenë të diplomuar si mjekë veterinerë nga Fakulteti i Mjekësisë Veterinare të Universitetit Bujqësor të Tiranës, çdo fakultet tjetër i mjekësisë veterinare, i themeluar dhe i njohur sipas ligjeve në fuqi, ose nga universitete të huaja, diploma e të cilëve u është nënshtruar procedurave të njohjes nga ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit në Republikën e Shqipërisë.

3. Teknikët veterinarë dhe teknikët e ndërzimit, për të fituar të drejtën për ushtrimin e profesionit, duhet të jenë diplomuar në arsimin

parauniversitarnë shkollat e mesme profesionale të njohura nga ministra përgjegjëse për arsimin profesional. Teknikët veterinarë dhe teknikët e ndërzimit nuk mund të jenë anëtarë të këtij Urdhri, por mund të regjistrohen në regjistër të veçantë dhe gjatë ushtrimit të profesionit janë të detyruar t'i nënshtrohen detyrimeve ligjore, statutit dhe Kodit të Etikës Profesionale të Mjekut Veterinar dhe akteve të tjera ligjore, të cilave u nënshtrohen mjekët dhe farmacistët veterinarë.

Neni 6
Mjekët veterinarë në pension

Mjekët veterinarë pensionistë që nuk ushtrojnë profesionin njihen si anëtarë të Urdhrit, pa qenë të detyruar të paguajnë kuotën e anëtarësisë. Kur ata punësohen ose vetëpunësohen, detyrohen të paguajnë kuotën e Urdhrit.

Neni 7
Përbërja e Urdhrit

1. Anëtarë të Urdhrit bëhen individët që:

a) janë diplomuar si mjekë veterinarë nga Fakulteti i Mjekësisë Veterinare të Universitetit Bujqësor të Tiranës, çdo fakultet tjetër i mjekësisë veterinare, i themeluar dhe njohur sipas ligjeve në fuqi, ose nga universitete të huaja, diploma e të cilave u është nënshtruar procedurave të njohjes nga ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit në Republikën e Shqipërisë;

b) pranojnë Kodin e Etikës Profesionale të Mjekut Veterinar dhe që e ushtrojnë këtë profesion në:

i) Shërbimin Veterinar Shtetëror;

ii) institucione, struktura dhe ente të tjera publike;

iii) shërbimin veterinar privat.

2. Përjashtohen nga ky detyrim, por jo nga e drejta e anëtarësimit në Urdhër, veterinerët funksionarë të administratës publike, për sa kohë që nuk ushtrojnë veprimtari të mirëfilltë profesionale veterinare.

3. Shtetasit e huaj, për ushtrimin e profesionit të mjekut veterinar në sektorin veterinar të Republikës së Shqipërisë, janë të detyruar të anëtarësohen në Urdhër, të njohin dhe të zbatojnë Kodin e Etikës Profesionale të Mjekut Veterinar, si dhe të gjitha aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë.

4. Të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve të Urdhrit përcaktohen në statut.

Neni 8
Ndalime

1. Asnjë individ nuk mund të ushtrojë profesionin e mjekut dhe farmacistit veterinar në Republikën e Shqipërisë dhe profesionin e teknikut veterinar dhe teknikut të ndërzimit, pa qenë përkatësisht anëtar i Urdhrit apo i regjistruar në Urdhër.

2. Punëdhënësve u ndalohet punësimi i individëve të paanëtarësuar apo të paregjistruar në Urdhër, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij neni, për të ushtruar profesionin e veterinerit në:

a) Shërbimin Veterinar Shtetëror;

b) institucione, struktura dhe ente të tjera publike;

c) shërbimin veterinar privat.

Neni 9
Ndërprerja e anëtarësimit

1. Anëtarit të Urdhrit i ndërpritet anëtarësia në këto raste:

a) kur vdes;

b) kur i hiqet e drejta e ushtrimit të profesionit me vendim disiplinor të formës së prerë nga organet e Urdhrit apo të gjykatës;

c) kur është duke vuajtur dënimin penal me heqje lirie;

ç) kur nuk shlyen kuotizacionet, në përputhje me afatet e vendosura nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit, dhe i kalon ato mbi 1 vit pa arsye të justifikueshme.

2. Vendimi për ndërprerje të anëtarësisë i komunikohet zyrtarisht personit dhe institucionit ku ka shërbyer i ndëshkuari.

Neni 10
Marrëdhëniet ndërinstitucionale

1. Urdhri, gjatë përmbushjes së funksioneve të tij, bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për veterinarinë, ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, me institucione, organizma dhe ente të tjera publike ose jopublike, në nivel qendror dhe vendor.

2. Për përmbushjen e kompetencave dhe funksioneve të tij, Urdhri ka të drejtë të lidhë kontrata dhe marrëveshje me subjekte të tjera, entitete publike apo private, si dhe me organizma

homologë ndërkombëtarë, sipas rastit, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në Shqipëri.

KREU III
STRUKTURA ORGANIZATIVE

Neni 11
Statusi

Urdhri është ent publik jobuxhetor, profesional, i pavarur, i cili përbëhet nga individë të cilët ushtrojnë profesionin veterinar në Republikën e Shqipërisë dhe mbron interesat e tyre.

Neni 12
Organet e Urdhrit

1. Urdhri është organizimi në nivel kombëtar i mjekëve veterinarë, që përfaqëson interesat e përbashkët të veterinerëve dhe rregullon marrëhëniet ndërmjet tyre, në funksion të interesit publik.

2. Organet e Urdhrit janë:

a) Asambleja e Përgjithshme;

b) Këshilli Kombëtar;

c) Komisioni Disiplinor;

ç) komisione të tjera, sipas këtij ligji.

Neni 13
Asambleja e Përgjithshme

1. Të gjithë anëtarët e Urdhrit janë pjesë e Asamblesë së Përgjithshme.

2. Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme janë përcaktuar në statutin e Urdhrit.

3. Asambleja e Përgjithshme mblidhet çdo vit, brenda datës 31 mars, sipas statutit, ku dorëzohet një raport i aktiviteteve të saj, të kryera përgjatë vitit, së bashku me një raport financiar, si dhe paraqet buxhetin për vitin pasardhës.

Neni 14
Këshilli Kombëtar

1. Këshilli Kombëtar përbëhet nga 21 anëtarë të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme dhe nga 4 anëtarë të tjerë si më poshtë:

a) drejtuesi i shërbimit veterinar shtetëror (CVO);

b) një përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë;

c) një përfaqësues i Fakultetit të Mjekësisë Veterinare të Universitetit Bujqësor;

ç) drejtuesi i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU).

2. Zgjedhjet për Këshillin Kombëtar bëhen çdo tre vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë për një mandat të dytë.

3. Procedura e zgjedhjes dhe shkarkimit të Presidentit, Zëvendëspresidentit dhe anëtarëve të Këshillit Kombëtar parashikohet në statutin e Urdhrit.

4. President dhe Zëvendëspresident zgjidhet një prej anëtarëve të Këshillit Kombëtar me mandat trevjeçar, me të drejtën e rizgjedhjes vetëm një herë. Funksioni i tyre është i papajtueshëm me funksione të tjera drejtuese, ekzekutuese apo menaxhuese të administratës shtetërore.

5. Brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, çdo ministër apo drejtues, sipas përcaktimit në pikën 1, të këtij neni, cakton përfaqësuesit përkatës dhe dërgon listën me emrat e tyre tek ministri përgjegjës për veterinarinë.

6. Organizimi dhe funksionimi i Këshillit Kombëtar përcaktohen në statutin e Urdhrit.

Neni 15
Kompetencat e Këshillit Kombëtar

Këshilli Kombëtar, në përputhje me misionin e Urdhrit dhe përcaktimet në këtë ligj, ushtron këto kompetenca:

a) përcakton dhe miraton strukturën organizative;

b) cakton kuotizacionin dhe tarifat, që i miraton me vendim;

c) menaxhon pasurinë/pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të Urdhrit, në nivel kombëtar;

ç) mbikëqyr dhe koordinon të gjitha veprimtaritë dhe aktivitetet e organeve apo strukturave që varen apo janë pjesë përbërëse e Urdhrit;

d) harton dhe miraton Kodin e Etikës Profesionale të Mjekut Veterinar, pasi ka kryer konsultimet me strukturat e tjera organizative të Urdhrit, jo më vonë se 12 muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji;

dh) harton dhe miraton statutin e Urdhrit, pasi ka kryer konsultimet me strukturat e tjera organizative të Urdhrit, jo më vonë se 3 muaj nga zgjedhja e tij;

e) miraton rregulloren për Komisionin Disiplinor brenda 3 muajve nga zgjedhja e tij;

ë) harton dhe miraton rregulloret përkatëse për komisionet e tjera.

Neni 16
Komisionet e tjera

1. Këshilli Kombëtar, bazuar në kompetencat e tij, krijon komisione të tjera të përkohshme apo të përhershme për:

a) përditësimin e regjistrave të urdhrit;

b) standardet, arsimimin dhe kualifikimin;

c) marrëdhëniet me jashtë dhe me publikun;

ç) planifikimin dhe kontrollin financiar dhe ekonomik;

d) botimin e periodikëve apo publikime të ngjashme.

2. Aktiviteti i këtyre komisioneve bazohet në rregulloret përkatëse të miratuara nga Këshilli Kombëtar.

Neni 17
Komisioni Disiplinor

1. Këshilli Kombëtar ngre një Komision Disiplinor për verifikimin dhe shqyrtimin e ankesave, në lidhje me shkeljet e Kodit të Etikës Profesionale të Mjekut Veterinar dhe shkeljet e tjera të kryera nga anëtarët e urdhrit.

2. Përbërja dhe procedura për zgjedhjen e Komisionit Disiplinor përcaktohen në statutin e Urdhrit.

3. Organizimi dhe funksionimi i Komisionit Disiplinor, si dhe kompetencat e tij përcaktohen në statut.

KREU IV
MASAT DISIPLINORE DHE ANKIMI

Neni 18
Masat disiplinore

1. Komisioni disiplinor heton dhe gjykon në bazë të fakteve e provave të administruara dhe seancës dëgjimore me anëtarin e Urdhrit, ndaj të cilit mund të merret masa disiplinore. Kur vërtetohet se anëtari ka kryer shkelje të Kodit të Etikës Profesionale të Mjekut Veterinar,ai jep këto masa:

a) vërejtje me shkrim;

b) vërejtje me paralajmërim;

c) gjobë nga 5000 (pesë mijë) deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, sipas një rregulloreje të posaçme lidhur me kushtet, procedurat e vendosjes së gjobave dhe masën konkrete për çdo shkelje, të miratuar nga Këshilli Kombëtar;

ç) heqje të së drejtës për t'u rizgjedhur në organet e Urdhrit, sipas këtij ligji, për një periudhë deri në 3 vjet;

d) përjashtim nga Urdhri për një periudhë deri në 3 vjet.

2. Masa disiplinore e parashikuar në shkronjën "d", të pikës 1, të këtij neni, sjell çregjistrimin nga regjistri i anëtarësisë.

3. Kur vërtetohet se tekniku veterinar dhe/ose tekniku i ndërzimit ka kryer shkelje të Kodit të Etikës Profesionale të Mjekut Veterinar, Komisioni Disiplinor jep këto masa:

a) vërejtje me shkrim;

b) vërejtje me paralajmërim;

c) gjobë nga 5000 (pesë mijë) deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

ç) heqje të së drejtës të ushtrimit të profesionit për një periudhë deri në 3 vjet.

4. Komisioni ka të drejte t'u caktojë kundërvajtësve, si masë plotësuese, kryerjen e një rikualifikimi në institucionet publike, sipas tarifave të përcaktuara.

5. Masat e mësipërme disiplinore vlerësohen të shlyera me kalimin e afatit kohor të përcaktuar në statutin e Urdhrit.

6. Komisioni Disiplinor kryen procedurat e përcaktuara në statut, mbështetur në Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe në akte të tjera nënligjore.

7. Gjobat e vjela sipas shkronjës "c", të pikës 1, dhe shkronjës "c", të pikës 3, të këtij neni, derdhen njëqind për qind në Buxhetin e Shtetit.

Neni 19
Ankimi

Për masat disiplinore ndaj tij, çdo person ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative te Komisioni Disiplinor dhe pastaj në rrugë gjyqësore, sipas legjislacionit në fuqi.

KREU V
BURIMET DHE MENAXHIMI I FINANCIMEVE

Neni 20
Burimet e financimeve

1. Urdhri ka buxhetin e vet, të cilin e administron në përputhje me legjislacionin financiar në fuqi.

2. Burimet financiare të Urdhrit janë:

a) kuotat e anëtarësisë, të detyrueshme për çdo anëtar, të cilat përcaktohen me vendim të Këshillit Kombëtar;

b) tarifat e tjera, të vendosura për aktet dhe dokumentet e lëshuara nga Urdhri, që përcaktohen me vendim të Këshillit Kombëtar;

c) donacionet e ndryshme, vendase e të huaja, dhe të ardhura të tjera të ligjshme;

ç) çdo e ardhur tjetër e ligjshme, e siguruar gjatë ushtrimit të aktivitetit të Urdhrit.

3. Të ardhurat e realizuara nga ushtrimi i veprimtarisë së vet, si dhe nga çdo aktivitet tjetër i ligjshëm do të përdoren nga Urdhri për të përmbushur misionin dhe funksionet e përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij.

KREU VI
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 21
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 23, pika 2, të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 22, pika 1, të këtij ligji.

Neni 22
Komisioni i përkohshëm për organizimin e zgjedhjeve të para

1. Brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ministri përgjegjës për veterinarinë ngre një komision të përkohshëm, i cili duhet të organizojë mbledhjen e parë të Asamblesë dhe zgjedhjen e Këshillit të parë Kombëtar, bazuar në urdhrin e ministrit përgjegjës për veterinarinë.

2. Këto zgjedhje duhet të bëhen brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

3. Me zgjedhjen e Këshillit kombëtar, komisioni i përkohshëm shkrihet.

Neni 23
Financimi

1. Urdhri financohet nga Buxheti i Shtetit për një periudhë njëvjeçare.

2. Procedura dhe mënyra e këtij financimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 24
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 15.10.2015

Shpallur me dekretin nr. 9289, datë 23.10.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 89/2015

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR TË KONTROLLUAR ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT NË FUQI PËR ADMINISTRIMIN E BAZAVE TË TË DHËNAVE SHTETËRORE TATIMORE

Në mbështetje të neneve 7, 77 dhe 78 të Kushtetutës, të neneve 5, 6, 8 e 9 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit", si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi për administrimin e bazave të të dhënave shtetërore tatimore, si dhe për të njohur dhe verifikuar në thellësi fenomenin e ndërhyrjeve dhe bllokimit për disa ditë të sistemeve elektronike tatimore, me synim parandalimin e këtij fenomeni negativ për shtetin, qytetarët dhe bizneset dhe nxjerrjen e përgjegjësive konkrete.

II. Objekti i punës së komisionit hetimor është:

1. Kontrolli izbatimit të legjislacionit tatimor në administrimin e bazave të të dhënave shtetërore nga ana e administratës tatimore për periudhën 12.11.2013 – 7.12.2013.

2. Njohja dhe verifikimi i problematikës së ndërhyrjeve në sistemet tatimore, me qëllim përcaktimin e mënyrës së kryerjes së këtij veprimi, si dhe identifikimin e përgjegjësive nga organet apo

personat zyrtarë përkatës, me synimin për frenimin me mjete ligjore të shfaqjes së tij në të ardhmen.

3. Njohja me arsyet e mosfunksionimit të sistemeve tatimore për disa ditë, me qëllim parandalimin e kësaj problematike të dëmshme në të ardhmen.

III. Komisioni ka të drejtë të hetojë dhe të bëjë transparencë të plotë për çdo çështje që përfshihet në objektin e punës së tij, në përputhje me parimet kushtetuese, veçanërisht parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, si dhe duke respektuar dhe duke mos mbivendosur kompetencat e organeve të drejtësisë.

IV. Komisioni hetimor, i ngritur sipas këtij vendimi, bashkë me raportin përfundimtar i paraqet Kuvendit në seancë plenare rekomandime në lidhje me nxjerrjen e përgjegjësive institucionale, ndryshime apo miratime ligjesh, me qëllim ndalimin përfundimtar të ndërhyrjeve të paligjshme në sistemet tatimore dhe, sipas rastit, njoftimin e prokurorisë për marrjen e masave të mëtejshme ligjore.

V. Komisioni hetimor parlamentar përbëhet nga 11 deputetë si më poshtë:

1.	Arben Ristani	Kryetar	(PD)
2.	Ervin Bushati	Zëvendëskryetar	(PS)
3.	Vasilika Hysi	Anëtare	(PS)
4.	Blerina Gjylameti	Anëtare	(PS)
5.	Ervin Koçi	Anëtar	(PS)
6.	Antoneta Dhim	Anëtare	(PS)
7.	Përparim Spahiu	Anëtar	(LSI)
8.	Jorida Tabaku	Anëtare	(PD)
9.	Florion Mima	Anëtar	(PD)
10.	Helidon Bushati	Anëtar	(PD)
11.	Sherefedin Shehu	Anëtar	(PD).

VI. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat 3-mujor nga data e miratimittë këtij vendimi.

VII. Ngarkohet Kryetari i Kuvendit që të caktojë menjëherë mjediset dhe mjetet e punës së komisionit, si dhe personelin e nevojshëm, duke vënë në dispozicion edhe ekspertë juristë.

VIII. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit që, brenda 5 ditëve nga miratimi i këtij vendimi, t'i kalojë komisionit të gjitha aktet, dokumentet apo informacionet e hartuara apo të administruara gjatë veprimtarisë së komisionit hetimor "Për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi për administrimin e bazave të të dhënave shtetërore tatimore, si dhe për të njohur dhe verifikuar në thellësi fenomenin e ndërhyrjes dhe bllokimit për disa ditë të sistemeve elektronike tatimore", të ngritur me vendimin nr.81/2014 të Kuvendit të Shqipërisë.

IX. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit që të marrë masa për zbatimin e vendimit të Kuvendit dhe të urdhrave të Kryetarit të Kuvendit për mbarëvajtjen e punës së komisionit, si dhe krijimin e kushteve të nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të tij.

X. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 22.10.2015

VENDIM
Nr. 90/2015

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR VERIFIKIMIN E LIGJSHMËRISË SË EMËRIMEVE NË DETYRË NË ADMINISTRATËN SHTETËRORE, ENTET PUBLIKE APO SHOQËRITË TREGTARE SHTETËRORE, PËR PERIUDHËN 15 SHTATOR 2013 – 30 SHTATOR 2015

Në mbështetje të neneve 7, 77 dhe 78 të Kushtetutës, të neneve 5, 6, 8 dhe 9 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit", si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për verifikimin e ligjshmërisë së emërimeve në detyrë në administratën shtetërore, entet publike apo shoqëritë tregtare shtetërore.

II. Objekti i veprimtarisë së komisionit hetimor është verifikimi i të dhënave për fenomenin e emërimeve të kundërligjshme dhe politike në administratën shtetërore, entet publike apo shoqëritë tregtare shtetërore, për periudhën 15 shtator 2013 – 30 shtator 2015, duke përfshirë emërimin e personave që kanë kryer veprime

kriminale apo trafikim të lëndëve narkotike.

III. Komisioni hetimor, i ngritur sipas këtij vendimi, bashkë me raportin përfundimtar i paraqet Kuvendit në seancë plenare rekomandime në lidhje me nxjerrjen e përgjegjësive institucionale, ndryshime apo miratime ligjesh dhe, sipas rastit, njoftimin e prokurorisë për marrjen e masave të mëtejshme ligjore.

IV. Komisioni ka të drejtë të hetojë dhe të bëjë transparencë të plotë për çdo çështje që përfshihet në objektin e punës së tij, në përputhje me parimet kushtetuese, veçanërisht parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, si dhe duke respektuar dhe duke mos mbivendosur kompetencat e organeve të drejtësisë.

V. Komisioni hetimor përbëhet nga 9 anëtarë. Kryetari dhe 3 anëtarë përfaqësues të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Zëvendës-kryetari dhe 4 anëtarë përfaqësues të grupeve parlamentare të partive tëmaxhorancës si më poshtë:

1.	Genc Pollo	Kryetar	(PD)
2.	Musa Ulqini	Zëvendëskryetar	(PS)
3.	Evis Kushi	Anëtare	(PS)
4.	Anila Agalliu	Anëtare	(PS)
5.	Ulsi Manja	Anëtar	(PS)
6.	Bujar Derveni	Anëtar	(LSI)
7.	Luçiano Boçi	Anëtar	(PD)
8.	Keltis Kruja	Anëtar	(PD)
9.	Alban Zeneli	Anëtar	(PD)

VI. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat 5- mujor nga momenti i konstituimit.

VII. Komisioni, me kërkesën e çdo anëtari, miraton pa votim thirrjen dhe caktimin e ekspertëve të jashtëm, që e asistojnë komisionin në veprimtarinë e tij.

VIII. Ngarkohet Kryetari i Kuvendit që të caktojë menjëherë mjediset dhe mjetet e punës së komisionit, si dhe personelin e nevojshëm, duke vënë në dispozicion edhe ekspertë juristë.

IX. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit që, brenda 5 ditëve nga miratimi i këtij vendimi, t'i kalojë komisionit të gjitha aktet, dokumentet dhe informacionet e hartuara apo të administruara gjatë veprimtarisë së komisionit hetimor të Kuvendit "Për verifikimin e ligjshmërisë së emërimeve në detyrë të realizuara gjatë periudhës 15 shtator 2013 deri më 31 maj 2014, në administratën shtetërore, entet publike apo shoqëritë tregtare shtetërore", të ngritur me vendimin nr. 82/2014 të Kuvendit të Shqipërisë.

X. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit që të marrë masa për zbatimin e vendimit të Kuvendit dhe të urdhrave të Kryetarit të Kuvendit për mbarëvajtjen e punës së komisionit, si dhe krijimin e kushteve të nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të tij.

XI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 22.10.2015

VENDIM
Nr. 866, datë 23.10.2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.638, DATË 22.7.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KUOTAT E PRANIMIT NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË, NË PROGRAMET E STUDIMEVE JOUNIVERSITARE PROFESIONALE DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, ME KOHË TË PLOTË, SI EDHE TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2015 - 2016"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 24, 34, 35, 36 e 75, tee ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", tënenit 135, të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit", të ndryshuar, tëligjit nr.7748, datë 29.7.1993, "Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", të ndryshuar, të ligjit nr.10289, datë 17.6.2010, "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjë-hershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe

të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye ose për shkak të detyrës",të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996, "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar,me propozimin eministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.638, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këtondryshime dhe shtesa:

1. Titulli i vendimit ndryshohet dhe zëvendësohet me: "Për kuotat e pranimit dhe tarifat e studimitnë ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2015 - 2016.".

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

"1/1. Kuotat e përgjithshme për pranimet e reja në programet e studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, janë 18239 kuota, nga të cilat 10360 kuota për programet e studimit të ciklit të dytë "Master Profesional" dhe 7879 kuota për programet e studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave", të shpërndara sipas shtojcës 1/1 bashkëlidhur këtij vendimi.

Përzgjedhja e studentëve për vitin akademik 2015- 2016 do të bëhet në bazë të kritereve të vendosura nga vetë institucionet e arsimit të lartë.".

3. Në fund të pikës 7 shtohen paragrafët, me këtë përmbajtje:

"Tarifa vjetore e shkollimit për studentët që regjistrohen në vitin e parë në programet e studimit të ciklit të dytë, me kohë të plotë, do të jetë sipas tabelave 1/1 dhe 2/2 bashkëlidhur këtij vendimi. Studentët, që do të transferojnë studimet në programe të ngjashme studimi, do t'i nënshtrohen tarifës për kredit të programit të studimit përkatës, të parashikuar në këtë vendim.

Shtetasit e huaj, që do të vazhdojnë studimet e ciklit të dytë në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen së njëjtës tarifë shkollimi, si shtetasit shqiptarë, me përjashtim të rasteve kur, në kuadër të marrëveshjes ndërshtetërore, është parashikuar ndryshe.".

4. Në fund të pikës 18 shtohen paragrafët,me këtë përmbajtje:

"Kuotat e pranimit për shtetasit e huaj, për shqiptarët nga trojet jashtë kufijve të vendit,për të verbrit, për romët dhe ballkano-egjiptianët, për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë,të përcaktuara në shtojcën1/1 të këtij vendimi, administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe shpërndahen bazuar në udhëzimin përkatës tëministrit të Arsimit dhe Sportit. Rishpërndarja e këtyre kuotave kryhet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Çdo program studimi i ciklit të dytë, me kohë të plotë, funksionon për vitin e parë, për vitin akademik 2015-2016, në rast se në këtë program studimi regjistrohen të paktën 10 studentë, përjashtuar Universitetin e Arteve, Tiranë. Për programet e studimit, për të cilat janë akorduar kuota për disa profile së bashku, institucionet publike të arsimit të lartë, në përfundim të aplikimeve u komunikojnë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Agjencisë Kombëtare të Provimeve programet e studimit me profilin përkatës,në të cilat ka të paktën 10 studentë të regjistruar dhe që do të fillojnë veprimtarinë akademike për vitin akademik 2015-2016.

Studentët, të cilët nuk e kanë përfunduar programin përkatës të studimit apo nuk kanë shlyer të gjitha provimet e parashikuara në atë program studimi, në kohëzgjatjen normale të tij,dhe konsiderohen studentë mbetës/përsëritës për lëndët përsëritëse, do të paguajnë çdo vit akademik dyfishin e tarifës për kredit të parashikuar në këtë vendim.

